



NDËRTIMI I TREGUESIT GJEOGRAFIKË PËR DJATHIN E SHARRIT - KOSOVË



Raporti afat-mesëm 2015-2018

Një kordinim aktorësh (jo një « projekt »)...

Ndërtimi i Treguesve Gjeografikë (TGJ) për dhe nga prodhuesit e djathit të Sharrit është një kordinim i aksioneve që ka për qëllim pronësimin e një mjeti european, si nga prodhuesit ashtu edhe nga grupet e interesit (institucionet publike dhe qeveritare).

Për të gjithë partnerët e këtij kordinimi, është një proces përvetësimi që ka filluar në vitin 2015 dhe që tani mund të konsiderohet si gjysëm i përfunduar.

...që kërkon implikimin e përbashkët të aktorëve në një mekanizëm evolutive dhe të të mësuarit

Procesi i krijimit të TGJ është bërë i mundur nga: mbështetja e dhënë nga Bashkimi European për institucionet e Kosovës, kryesisht nëpërmjet 4 misionëve TAIEX të ekspertëve francez të INAO (Instituti kombëtar i origjinës dhe cilësisë) ; studime pjesëmarrëse (me prodhuesit dhe aktorët përkatës) të diagnostikës agro-ekologjike mbi mjedisin natyror, përcaktimin e karakteristikave të djathit dhe sistemet e tyre të prodhimit (AgroParisTech, FFEM, AIDA) ; vendosje në lidhje me institucione publike (ministrat përkatës dhe Parku Kombëtar i Sharrit), implikimi i tyre në procesin e të të mësuarit si dhe mbështetja në krijimin e Shoqatës së prodhuesve të djathit të Sharrit – ndërmarrë kryesisht nga shoqata KsIPP (Instituti Kosovar për Pronësi Intelektuale).





AIDA - Shoqatë Ndërkombëtare për Zhvillimin e Agro-mjedisit.
Me mbështetjen e **Ambasadës së Francës në Kosovë**.
Në partneritet me **Institutin Kosovar të Pronësisë Intelektuale**.



Sharri, djathi dhe prodhuesit e tij

Territori


- **Etapë e përfunduar :**
 - Kufizimi i territorit të prodhimit të djathit të Sharrit perceptuar nga prodhuesit.
 - Analizë gjeomorfologjike, agro-ekologjike dhe peizazhere të masivit të Sharrit
 - Ndarja e territorit në 4 nën-ndarje gjeomorfologjike : (1) Gora, (2) Opoja, (3) Zhupa, (4) Strpce
- **Për t'u përcaktuar në « Librin e Kërkesave » :**
 - Të përcaktohet (ose jo) hapësira (1) e kullotës, (2) e originës së ushqimit shtazor, (3) e mbledhjes së qumështit, (4) e transformimit dhe rafinimit, dhe (5) e paketimit.



Hapësira e kullotave të masivit të Sharrit (pjesa e Kosovës) vlerësohet me 28 000 ha. Pjesa më e madhe e kullotave malore dhe e prodhimit të djathit të Sharrit gjendet në zonën e Gorës dhe Opojës.

Sistemet e prodhimit dhe praktikat kullotore

- **Etapë e përfunduar :**
 - Përshkrimi i praktikave pastorale : mënyrat e ushqyerjes së kafshëve, përdorimit të kullosave, zonave me kullotave të lëvisshme.
 - Tipologjia e sistemeve të prodhimit, përshkrime dhe lokalizime.
 - Analzë e detajuar e historisë agrare të Sharrit dhe evolucioni i sistemeve të prodhimit përgjatë kohës.
- **Per tu përcaktuar në « Librin e Kërkesave » :**
 - Praktikrat në lidhje me përdorimin dhe ushqyerjen e kafshëve, duke kushtëzuar atributin e TGJ.



Shembull ilustrues i përshkrimit të sistemeve të prodhimit : lloji « blegtor lopë miks shtegëtim »

* Miks = qumështore + mishnore


** Dele të marra në ngarkesë nga një person (çoban) i cili kujdeset duke i ushqyer dhe ruajtur kundrejt një çmimi të paracaktuar.

Djathi dhe praktikrat e transformimit


- **Etapë e përfunduar :**
 - Përshkrimi i parë i proceseve të ndryshme të djathrave të shitur nën emrin e Sharrit : transformim fermeri, artizanal, industrial.
 - Krijimi i një baze të dhënash të prodhuesve të djathit, emërtuar « të Sharrit » (metoda të ndryshme rritje dhe metoda prodhimi).
 - Prezantimi i parë i karakteristikave të djathit duke filluar me një seancë shije
- **Për tu përcaktuar në « Librin e Kërkesave » :**
 - Karakteristikat shqisore të djathit të Sharrit.
 - Lloji/et et qumështit të përdorur : dele, lopë, dhi.
 - Les étapes clés du processus de transformation. Etapat kyce të procesit të transformimit.
 - Lloji/et e paketimit (në kavanoza, në bukë, të dyja, etj).

Dalja në treg e djathit

- **Etapë e përfunduar :**
 - Identifikimi i aktorëve të filierës
 - Skematizimi trajektoreve të daljes në treg.
 - Vlerësimi i prodhimit në terma volumi
- **Për tu përcaktuar :**
 - Vlerësimi i volumeve të prodhuara sipas mënyrave të prodhimit dhe transformimit
 - Vlerësimi i tregjeve dhe konsumatorëve potencial të djathit si TGJ.



- **Studime plotësuese që do të ishin të nevojshme :**
 - Studim mbi prodhimin e djathit të Sharrit në Maqedoninë e Veriut.
 - Studim më i thelluar në lidhje me marketingun e djathit të Sharrit dhe tregjeve potenciale.



Aktorët

Realizimi i anketave të ndryshme në terren, gjatë viteve të fundit, kanë mundur identifikimin e një numri aktorësh që i përkasin djathit të Sharrit dhe ndërtimit të TGJ. Gjatë etapave të ardhshme të ndërtimit të TGJ, do të duhet një kujdes i vecantë në përfshirjen e (1) territoreve, (2) komuniteteve (3) sistemeve të prodhimit, dhe (4) llojeve.

Dhjetë lloje sistemesh prodhimi të djathit të Sharrit u përcaktuan nga përbërja e tufës, praktikrat e rritjes, prodhimit kryesor (qumësht/mish), etj. Sistemet e dhive nuk përshkruhen duke qënë se janë thujse joekzistuese.

Treguesit Gjeografikë dhe BE

Më shumë se 1600 produkte ushqimore janë të identifikuar me Tregues Gjeografikë në Bashkimin Europian.

Katër dimensionet potenciale të një TGJ

Treguesit Gjeografikë janë:


- (1) mjete tregu që mundësojnë vlerësimin e produkteve karakteristika të veçanta,
- (2) një faktorë zhvillimi rural dhe lokal gjithëpërfshirës,
- (3) gjithnjë e më shumë të përdorshëm si iniciatorë në mbrojtjen e mjedisit dhe implementimin e praktikave të qëndrueshme,
- (4) si përfundim, këto Tregues janë mekanizma të lokalizuara *ad hoc* që prezantohet nga aktorë lokalë & grupe interesi, si dhe një objekt partneriteti, bashkëpunimi dhe rrjeti.

Cështje të Treguesve Gjeografikë në Kosovë


Sot, Kosova nuk ka rregjistruar akoma asnjë TGJ.

Arsyet për të rregjistruar djathin e Sharrit si TGJ janë të shumëllojshme :

- harmonizimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Europian (*acquis communautaire*)
- vlerësimi i produkteve me cilësi të veçanta në tregun e përbashkët europian,
- mbështetja e kullotave si bujqësi shumëfunksionale
- mbrojtje kundër fallsifikatorëve
- informim i konsumatorit
- informim në të gjithë zinxhirin e vlerës së produkteve
- strukturim i rrjetit të produkteve cilësore,
- vlerësimi dhe ruajtja e territorit, trashëgimisë dhe identitetit ndër-komunitar.
- mbrojtja e agro-biodiversitetit të një territori natyror të veçantë (Parku Kombëtar i Sharrit).



Etapat e përfunduara



Etapat e ardhshme

Në vjeshtë 2019 : → Miratimi i « Librin e Kërkesave » për djathin e Sharrit dhe rregjistrim !

Programi tre-vjeçarë 2019-2021

Forcimi i Shoqatës së prodhuesve me qëllim për:

- të siguruar karakterin përfshirës të Shoqatës,
- të ndërtuar mjete komunikimi të brendshme dhe të jashtme,
- të përpunuar një agjendë promociionale tek konsumatorët,
- të mbikqyrë projektet dhe të sigurojë lidhjet me institucionet përkatëse,
- të mbështesë dhe vlerësojë studime plotësuese.